

2384.

Në bazë të nenit 34 paragrafi 5 të Ligjit për materialin arkivor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 95/2012), drejtori i Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë miratoi

**RREGULLORE**  
**PËR KUSHTET KADROVIKE, TEKNIKE DHE HAPËSINORE TË CILAT DUHEN**  
**PLOTËSUAR QENDRAT DOKUMENTARE PËR MBROJTJE, RRUAJTJE DHE**  
**SHFRYTËZIMIN TË MATERIALIT PRIVAT DHE MATERIALIT DOKUMENTAR**

**I DISPOZITA E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet kadroviqe, teknike dhe hapësinore të cilat duhen plotësuar qendrat dokumentare për mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzimin e materialit privat dhe materialit dokumentar.

**II KUSHTET KADROVIKE TË CILAT DUHET TI**  
**PLOTËSOJNË QENDRAT DOKUMENTARE**

Neni 2

Qendra dokumentare posedon kapacitet të kuadrit me kohë , të ndërgjegjshëm, profesionale të vazhdueshme për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e materialit.

Qendra dokumentare vazhdimisht mban organizatë në të cilën ka të paktën 4 (katër) punonjës në punësim të plotë, me arsim të lartë - arkivistë të diplomuar.

Qendra dokumentare e cila në funksionimin e saj përdor teknologji informatike për pranim, ruajtje dhe shfrytëzim të materialit dokumentar arkivor në formë jokonvencionale ka më së paku një punonjës me orar të plotë, me arsim të lartë në fushën e informatikës dhe teknologjisë.

Punonjësit në qendrën dokumentare janë të aftë për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit, gjithësisht për:

- Përpunimin dhe pranim të planeve të njohurive arkivore dhe listat e materialit dokumentar arkivor,
- Përzgjedhje praktike e materialit arkivor dokumentar, ndarja dhe shkatërimi i materialit dokumentar,
- Rregullim, evidentim dhe përpunim të materialit,
- Digjitalizim të materialit,
- Qasje dhe përdorim të materialit.

### III KUSHTET HAPËSINORE DHE TEKNIKE TË CILAT DUHET TI PLOTËSOJNË QENDRAT DOKUMENTARE

#### **Kushtet hapësinore për rruajtjen dhe mbrojtjen e materialit**

##### Neni 3

Qendra dokumentare disponon Depo dokumentare me hapësirë dhe pajisje të përshtatshme për akomodim, rruajtje dhe mbrojtje të materialit dokumentar arkivor, si dhe hapësirë administrative.

Depoja dokumentare është një hapësirë fizike e përcaktuar qartë dhe e krijuar me karakter të përhershëm dhe të ndërtuar në mënyrë sizmike të përballojë një tërmet të fortë dhe duhet të:

- Ndodhet jashtë pellgut ujmbjellës dhe shtratit të lumit,
- Ka qasje fizik dhe elektronik të kontrolluar,
- Zotëron dhe aplikon një sistem alarmi për zbulimin dhe raportimin e qasjes së paautorizuar ose ka organizuar shërbim sigurie,
- Siguron rezistencë ndaj zjarrit të paktën 60 minuta nga ndikimet e jashtme,
- Ka një instalim të brendshëm elektrik korrekt dhe të kontrolluar,
- Ka një sistem për zbulim të hershëm, sinjalizimin dhe raportimin e zjarrit dhe mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve PP,

Depoja dokumentare është një hapësirë fizike e përcaktuar qartë dhe e krijuar me karakter të përhershëm dhe të ndërtuar në mënyrë sizmike të përballojë një tërmet të fortë dhe duhet të:

- Ndodhet jashtë pellgut ujmbjellës dhe shtratit të lumit,
- Ka qasje fizik dhe elektronik të kontrolluar,
- Zotëron dhe aplikon një sistem alarmi për zbulimin dhe raportimin e qasjes së paautorizuar ose ka organizuar shërbim sigurie,
- Siguron rezistencë ndaj zjarrit të paktën 60 minuta nga ndikimet e jashtme,
- Ka një instalim të brendshëm elektrik korrekt dhe të kontrolluar,
- Ka një sistem për zbulim të hershëm, sinjalizimin dhe raportimin e zjarrit dhe mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve PP,
- Ka një raport për mbrojtje nga zjarri, bazuar në shuarjen me ndihmën e dioksidit të karbonit, kimikateve të thata dhe shkumës së përhapur,
- Ka raport për mbrojtjen higjienike dhe teknike , ka një plan për evakuimin dhe mbrojtjen e materialeve në kushte emergjence dhe lufte,
- Disponon udhëzues topografik për sistemimin dhe vendosjen e materialit arkivor dhe dokumentar të poseduesve, siguron ndriçim anësor në depon ku rruhet materiali,
- Ka rafte standarde metalike, kuti arkivore për akomodimin, rruajtjen dhe mbrojtjen e materialit,
- Siguron akomodimin dhe rruajtjen e materialit në dosje dhe kuti të bëra prej letre neutrale ose kartoni me trashësi mesatare.
- Një herë në vit kryhen dezinfektim dhe deratizim të hapësirës.

##### Neni 4

Qendra dokumentare mund të organizojë edhe një nivel më të lartë mbrojtjeje nëpërmjet krijimit dhe menaxhimit të një kasaforte arkivore, për të cilën duhet të ketë një platformë tekniko-teknologjike për kontrollin dhe përdorimin e veçantë të materialit.

Kasaforta arkivore është një hapësirë fizike e përcaktuar me konstruksion të fortë për ruajtjen e konvencionale të materialit arkivor dhe dokumentar dhe duhet të:

- Zotëron një statikë të ndërtimit të tij prej 9+ gradë sipas shkallës sizmike Evropiane,
- Të ndodhet jashtë pellgut ujëmbledhës dhe shtratit të lumit,
- Zotëron dhe aplikon qasje të dyfishtë të kontrolluar ( fizik dhe elektronik)
- Zotëron dhe aplikon sistem alarmi për zbulimin dhe raportimin e qasjes të paautorizuar,
- Siguron certifikatë rezistencë ndaj zjarrit prej 180 minuta
- Siguron sistem të hershëm për zbulimin , raportimin dhe shuarjen e zjarrit, sipas raportit të certifikuar të PP
- Zotëron laborator për mbrojtje higjienike dhe teknike
- Siguron temperaturë konstante dhe të kontrolluar prej 16 deri në 20 gradë Celsius dhe një lagështi relative prej 35 deri në 45 %
- Siguron mbrojtje antistatike.
- 

#### Neni 5

Qendra dokumentare që përdor një platformë teknologjike të bazuar në softwer dhe që ofron qasje, shkëmbim dhe përdorim të materialit arkivor dhe dokumentar në mënyrë elektronike organizon qasje, shkëmbimin dhe përdorimin e duhur duke ruajtur dokumentet dhe të dhënat brenda standardit të Arkivit Safe ose Server Room.

Një dhomë serveri është një hapësirë e përcaktuar në të cilën dokumentet dhe të dhënat ruhen në një formë jokonvencionale dhe duhet:

- Zotëron dhe aplikon qasje të kontrolluar me një bravë fizike dhe elektronike,
- Siguron rezistencë ndaj zjarrit në një mjedis të jashtëm prej të paktën 60 minutash
- Zotëron dhe aplikon një sistem alarmi për zbulimin dhe raportimin e qasjes së paautorizuar
- Zotëron dhe aplikon një sistem alarmi për zbulimin dhe njoftimin e hershëm të zjarrit,
- Zotëron dhe aplikon një sistem shuarje zjarri zyrtare.
- Zotëron dhe aplikon sistem mbrojtjeje nga mikroklima me një temperaturë konstante dhe të kontrolluar prej 16 deri 22 gradë Celsius dhe lagështia nga 35 në 50%, e shquar në një pajisje matëse të kalibruar dhe të certifikuar,
- Ka mbrojtje adekuate antistatike.
- 

#### Neni 6

Qendra dokumentare aplikon dhe disponon një sistem të teknologjisë së informacionit (hardware dhe softwer) për menaxhimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe përdorimin e dokumenteve jokonvencionale, për digjitalizimin e dokumenteve në letër dhe për mikrofilmimin e dokumenteve elektronike.

### IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”